

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Niveli: Master- Penal

Tema: “Dënimet alternative me vështrim të posaçëm dënimit me kusht në territorin e Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega Podujevë gjatë periudhës 2016/2020”

Kandidatja: Egzona ZEJNULLAHU

Mentori: Prof. Dr. Rexhep GASHI

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë shqiptimin e dënimeve alternative, me fokus të veçantë dënimin me kusht, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë. Metodot kërkimore që janë përdorur janë metoda historike, analiza ligjore, metoda statistikore dhe studimi i rasteve gjyqësor, po ashtu kam përdorur metodat e modelit, mesatares dhe përqindjes. Rezultatet kërkimore tregojnë se dënimi me kusht është dënimi alternativ më i shpeshtë në gjykatën e studiuar, dhe se ai aplikohet kryesisht për vepra penale me rrezikshmëri të ulët ose mesatare. Konkluzionet e punimit janë se dënimi me kusht ka një rol rehabilitues dhe riedukues për personat e dënuar, por edhe disa sfida në zbatimin dhe monitorimin e tij. Rekomandimet e punimit janë që të forcohet bashkëpunimi mes gjykatave, shërbimit sprovues dhe institucioneve të tjera relevante, të rritet sensibilizimi dhe informimi i publikut për dënimeve alternative, dhe të zhvillohen studime më të thelluara për efektet dhe impaktin e dënimeve alternative në nivel kombëtar. Informata shtesë që mund të interesojnë lexuesin janë historitë dhe profilet e personave të dënuar me dënime alternative, si dhe krahasimi i praktikave të Kosovës me praktikat e vendeve të tjera evropiane në fushën e dënimeve alternative.

Fjalët kyçe: *Dënimet alternative, dënimi me kusht, veprat penale, riedukimi, risocializimi, recidivizmi, gjykata, shërbimi sprovues, Podujevë.*